



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pimljena / Prodato Received / Delivery	18 - 08 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHICK	4788/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.603/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti - kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.603/2022 të datës 06.07.2022, të parashtruar nga ankuesja _____ me adresë banimi _____ kundër organit të punësimit/Komuna e Klinës, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 18.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.603/2022 e datës 06.07.2022 e parashtruar nga ankuesja _____
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Klinës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e pagës së ankueses sipas koeficientit të pagës të përcaktuar me Ndryshim dhe Plotësim Akt-in e Emërimit Nr.112-1490/22 të datës 11.01.2022 si dhe në mënyrë retroaktive të kompensoj diferencën e koeficientit të pagës nga gjashtë (6.0) në shtatë (7.0) duke filluar data e nxjerrjes së Vendimit me numër 01-Nr.112-1179/2022 të datës 11.01.2022.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ është punësuar në Komunën e Klinës fillimisht sipas Akt emërimit 02Nr.112-2955/11 të datës 01.08.2011, në pozitën Zyrtare e te hyrave ne Drejtorinë për financa. Me datën 12.02.2015 ndaj të njëjtës është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Akt emërimit Nr.112-1252/15 të datës 12.05.2015, me arsyetimin se e njëjta pas marrjes së titullit Bachelor i arteve në shkencë politike dhe administratë publike mban koeficientin gjashtë (6.0) në pozitën si Zyrtare e të hyrave në Drejtorinë për financa.



Të njëjtës me Vendimin me numër 01-Nr.112-1179/2022 të datës 11.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Klinës i është aprovuar ngritja e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin shtatë (7), me qëllim që nëpunësi civil të realizoj të drejtën në pagë në përputhje me punën dhe detyrat e punës si dhe praktiken në nivel vendi pasi që për pozitën e tillë parashihet koeficienti 7.0 dhe konform këtij vendimi ankueses i është lëshuar Ndryshimi dhe plotësim Akti i Emërimit me numër 01-Nr.112-1490/22, duke përcaktuar koeficient shtatë (7.0) të pagës.

Ankuesja me datën 10.06.2022, përmes e-mailit zyrtar i është drejtuar me shkrim Zyrës së Personelit të Komunës së Klinës, me kërkesë për ekzekutimin e pagesës sipas vendimit të kryetarit të komunës së Klinës. Ndërsa kjo e fundit me datën 10.06.2022 në përgjigje të ankueses njofton të njëjtën se Zyra e Personelit ka ndërmarr të gjitha veprimet procedurale lidhur me ekzekutimin e pagesës mirëpo ministria përkatëse nuk ka ndërmarrë asnjë veprim.

Ankuesja e pa kënaqur me përgjigjen e datës 10.06.2022 të Zyrës së Personelit në Komunën e Klinës, me datën 06.07.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 3947/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së Zyrës së Personelit të Komunës së Klinës të datës 10.06.2022, për shkak të mos zbatimit të ndryshimit dhe plotësimit të Akt Emërimit me 01Nr.112-1490/22 të datës 11.01.2022 dhe mos realizimin e pagës konform këtij akti.

Në përgjigjen në ankesë, Organi i punësimit deklaron se Komuna e Klinës përmes Zyrës së Personelit disa herë radhazi ka bërë përpjekje tek Thesari i Kosovës lidhur me realizimin dhe harmonizimin e koeficienteve konform Akt emërimeve, pasi që Komuna posedon dhe ka ndarë mjete buxhetore mirëpo nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Thesari i Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 18.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës. Ndërsa Këshilli, me datë 02.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3947/2022 të datës 06.07.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin 01Nr.112-1179/2022 të datës 11.01.2022 nga Kryetari i Komunës së Klinës; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit të ankueses 01Nr.112-1490/22 të datës 11.01.2022; Listën e pagave për ankuesen sipas koeficientit 6; Kërkesën përmes e-mailit zyrtar të datës 10.06.2022 nga ankuesja për Zyrën e personelit në Komunën e Klinës; Kërkesën për sqarim përmes e-mailit zyrtar të datës nga Njësia për burime njerëzore e komunës së Klinës për ankuesen; Kërkesën për rritje të koeficientit datës 18.01.2022 nga Drejtoria për buxhet dhe financa e komunës së Klinës drejtuar Ministrisë së financave, punës dhe transfereve; Formularin e shpenzimit të departamentit, divizionit ose sektorit; Formularin e shpenzimit të departamentit, divizionit ose sektorit; Kërkesën për përgjigje në ankesë në ankesë të datës 18.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 02.08.2022 nga Komuna e Klinës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Akt emërimit të ankueses 02Nr.112-2955/11 të datës 01.08.2011; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit të ankueses 02Nr.112-1252/15 të datës 12.02.2015; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i të hyrave financiare.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 19 ku theksohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërlidhur me këtë neni 3 i Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ka përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezultoi se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civilë të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës ju garantohet dhe duhet të realizojnë pagë të njëjtë për punë të njëjtë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosje meritorë të kësaj çështje juridike ka analizuar edhe nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë me të cilin është përcaktuar se: *1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat....* andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji gjen së organi i punësimit ka ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për harmonizimin e koeficientit të ankueses mirëpo ky harmonizim nuk është ekzekutuar nga ministria përgjegjëse respektivisht nga Thesari i Kosovës, kështu që, në rrethanat e rastit në fjalë ankuesja në kuptim të realizimit të së drejtës së pagës është dhe vazhdon të trajtohet në mënyrë me pak të favorshme se sa nëpunësit civilë të cilët ushtrojnë pozitë të njëjtë të punës në institucionet tjera publike, rrjedhimisht sipas Kolegjit veprimet e tilla lidhur me mos miratimin e harmonizimit të koeficientit të pagës për ankuesen janë në kundërshtim edhe me parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë konkretisht nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë*, e mbi këto arsye Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara dhe të ligjshme.

Për më tepër, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përkatësisht nenit 3 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, si dhe paragrafin 2 ku përcaktohet se: 2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlefësoj ose çenoi njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës*. Rrjedhimisht mbi bazë të dispozitave të specifikuar më lartë pretendimi i ankueses është i bazuar për faktin se për punë të njëjtë nuk mund të ketë pagë të ndryshme dhe nëse marrim për bazë ndryshim/plotësimin e aktit të emrimit nga zyrtari kryesor administrativë në këtë rast Kryetari i Komunës së Klinës i cili është bërë

me qëllim të harmonizimit të pagës së nëpunëses brenda këtij institucioni me zyrtarë tjerë të njëjtit nivel dhe që kryejnë punë të njëjtë është një argument shtesë që vërteton faktin se paga ndryshe nga zyrtarët që kryejnë punë të njëjtë bie ndeshë me dispozitat e specifikuara më lartë e që kanë të bëjnë me diskriminim.

Andaj, bazuar në rrethanat si me lartë, obligohet Kryetari i Komunës së Klinës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e pagës së ankueses sipas koeficientit të pagës të përcaktuar me Ndryshim dhe Plotësim Aktin e Emërimit Nr.01-112-1490/22 të datës 11.01.2022 si dhe në mënyrë retroaktive të kompensoj diferencën e koeficientit të pagës nga gjashtë (6.0) në shtatë (7.0) duke filluar data e nxjerrjes së Vendimit me numër 01-Nr.112-1179/2022 të datës 11.01.2022.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të inicojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.603/2022, datë 18.08.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankueses
- ❖ Kryetarit të Komunës së Klinës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

